



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:165446

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453203

KA.nr. 497/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Beta Group” Sh.P.K. me seli në rrugën “Sadik Shala” nr. 146 në Lipjan, të cilin e përfaqëson në bazë të prokurës shoqëria e avokatëve “SCLR Partners” me seli në soliterin Avalla P+12 në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrative, jashtë seancës më 14 mars 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit “Beta Group” Sh.P.K me seli në Lipjan, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar ndryshimin ose anulimin e vendimit me numër ref.ZSP.1013/20 të datës 26.10.32020 së të paditurit.

ARSYETIM

Paditësi më datë 26.11.2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka ushtruar padi, kundër të Paditurës, me të cilën i ka kërkuar ndryshimin ose anulimin e vendimit me numër ref.ZSP.1013/20 të datës 26.10.32020 së të paditurit.

Megjithatë Paditësi përmes parashtresës së datës 14.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë.

Duke marr për bazë se sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ, sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.497/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.